

MINISTRIA E DREJTËSISË

DITARI MUJOR

PRILL 2024



MIRATOHET LIGJI I AMNISTISË PENALE



Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, ka finalizuar me sukses ligjin për Amnistinë Penale, duke marrë mbështetjen e 116 ligjvënësve në Kuvendin e Shqipërisë. Nga kjo amnisti, më e madhja e bërë ndër vite, përfitojnë rreth 825 të dënuar të cilët lirohen menjëherë, 2662 qytetarë në shërbim prove, si dhe 905 të dënuar të tjerë përfitojnë ulje dënimi!

MINISTRI MANJA TAKIM ME PROKURORIN E PËRGJITHSHËM TË MBRETËRISË SË SPANJËS, Z. ALVARO GARCÍA ORTIZ



Ministri Manja mbajti qëndrime të përbashkëta për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërgjyqësor në fushën penale ndërmjet Shqipërisë dhe Spanjës, me Prokurorin e Përgjithshëm të Mbretërisë së Spanjës, z. Alvaro García Ortiz. Fuqizimi i drejtësisë është rruga drejt një shoqërie të drejtë dhe të barabartë, u shpreh ai.

MIRATOHET NË KUVEND PROJEKTIGJI PËR DISA SHTESA NË LIGJIN PËR PËRKTHYESIT ZYRTARË



Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 72 vota pro ndryshimet ligjore në ligjin për përkthyesit zyrtarë, që i japin zgjidhje problematikave të komunikimit zyrtar me gjuhët më pak të folura! Në kushtet kur Shqipëria ka hapur dyert për turizmin, e ku fliten të gjitha gjuhët e botës, këto ndryshime lehtësojnë urat e komunikimit mes autoriteteve dhe njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme!



HYN NË FUQI LIGJI I AMNISTISË PENALE. FILLON LIRIMI I TË DËNUARVE PËRFITUES, MANJA PËRSHËNDET PROCESIN NGA IEVP RROGOZHINË

Një ditë e shumëpritur për përfituesit e ligjit të Amnistisë Penale! Në të gjitha IEVP e vendit nisi procesi i lirimit të të dënuarve që përfituan nga ky ligj. Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, përshëndeti procesin nga IEVP Rrogozhinë dhe përcolli disa mesazhe për ata që përfituan nga amnistia dhe u ribashkuan me familjet e tyre



TAKIM PËRMBYLLËS ME DELEGACIONIN E NËN-KOMITETIT TË OKB-SË PËR PARANDALIMIN E TORTURËS (SPT)

Takim përmbyllës me delegacionin e Nën-komitetit të OKB-së për Parandalimin e Torturës (SPT), pas misionit të tyre monitorues për kushtet e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Shqipëri, me fokus të veçantë rastet e trajtimit arbitrar dhe degradues të tyre! Si Ministër i Drejtësisë, Manja konfirmoi politikën riintegruese dhe risocializuese që ndiqet në trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në Shqipëri dhe se sistemi ynë i paraburgimit dhe dënimit është nën monitorimin e vazhdueshëm të Avokatit të Popullit dhe Mekanizmit Kundër Torturës, organizatave të shoqërisë civile, por dhe të organizmave evropiane dhe ndërkombëtare që monitorojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut!



MINISTRI MANJA NË MBËSHTETEJE TË NOTERËVE. TAKIM ME PRESIDENTIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË NOTERËVE TË ITALISË

Bashkëpunimi noterial mes Shqipërisë dhe Italisë do të njohë zhvillime të tjera cilësore! Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja, zhvilloi një takim produktiv me presidentin e Këshillit Kombëtar të Noterëve të Italisë, z. Giulio Biino dhe presidenten e Dhomës Kombëtare të Noterëve të Shqipërisë, znj. Mimoza Sadushaj.



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministra_drejtises
ulsimanja



@manja_uls